

HENRIK LACAJ

SKËNDERBEU NË LETËRSINË ITALIANE

Ishte e natyrshme që edhe popujt e tjerë, të tërhequn nga heroizmat dhe fitoret e Skënderbeut, të mos mjaftoheshin vetëm me disa ndjenja a shprehje admirimi e respekti ndaj tij, por të jepnin edhe diçka konkrete në fushën e historisë e të letërsisë.

Fama lavdiplotë e heroit tonë kombëtar preku e mobilizoi shumë shkrimtarë të huej për vepra historike e letrare. Që nga shekulli XVI e këtej ne gjejmë në Itali poetë e prozatorë që këndojnë e naltësojnë në veprat e veta vetitë e meritat e mëdha të Skënderbeut. Pikërisht në fund të shekullit të naltpërmendun dhe nga fillimi i shekullit të pastajmë na çfaqet figura e heroit tonë në katër vepra italiane, nga të cilat tri janë poema heroike dhe një tragjedi. Faktorë të ndryshëm kushtëzuen një trajtim të tillë. Dhe me të vërtetë qysh me Petrarkën e Bokaçin, pionerë të Humanizmit, bota intelektuale përparimtare po kthehej drejt modeleve të klasicizmit greko-romak; një lëvizje e tillë kulturalë plotësohej me zgjimin dhe zhvillimin e shpejtë të letërsive kombëtare. Kundrejt ndrydhjes së personalitetit të njeriut dhe obskurantizmit mesjetar po lindte një rrymë e re, që synonte ta ngrinte dinjitetin e njeriut, rrymë kjo që u pasqyrue sidomos në veprat e artit. Kështu në Itali filloi të lulëzojë i quejtuni «Rinascimento». Pikërisht gjatë kësaj periudhe zuni të rindrisë figura e Skënderbeut në sajë të pendës së patriotit dhe të humanistit tonë Marin Barlecit, vepra e të cilit shquhet për vetitë e një epopeje në prozë; atëherë gjetën jehonë në letërsinë italiane heroizmat, fitoret dhe lavdia e kreshnikut krutan.

Për ma tepër, gjatë kësaj epoke dalin në Itali një seri poemash, ndërmjet të cilave dallohet «Orlandi i furishëm» i Ludovik Ariostos (Ludovico Ariosto) dhe «Jeruzalemi i çliruem» i Torkuato Tasos (Torquato Tasso), vepra këto, që, sidomos përsa i takon anës kompozionale dhe metodës artistike, u hartuen simbas modelit të veprave epike të antikitetit, d.m.th. të Iliadës dhe të Eneidës. Veçanërisht Torkuato Taso me kryeveprën e vet ndikoi shumë mbi disa poetë minorë të epokës, tre prej të cilëve qenë ata që trajtuen në poemat e veta figurën e Skënderbeut: Baldazar Skarameli, një anonim dhe Margerita Sarroki.

Përsa i takon subjektivitetit, mund të thomi me bindje të plotë se faktori kryesor që i entuziazmoi, që i frymëzoi dhe që i shtyu këta poetë të rroknin pendën për të këndue Skënderbeun, qe personaliteti dhe roli i tij si udhëheqës, si organizues, si trim i pashoq dhe si mbrojtës i qytetnimit kundër barbarizmit; sepse figura e Gjergj Kastriotit i kapërceu kufijt e atdheut të tij dhe u ba një figurë ndërkombëtare

në sajë të idealit dhe të gjenialitetit të tij. Pra figura e Skënderbeut u ba simbol heroizmi e lirie dhe ushqe aspiratat e poetëve, të shkrimtarëve, të masave, që shikonin në këtë hero mbrojtësin dhe shpëtimtarin jo vetëm të atdheut të tij, por edhe të Ballkanit edhe të Evropës nga një fuqi e madhe pushtuese siç ishte Turqia e asaj kohe.

Baldazar Skarameli, për jetën e të cilit, veç një episodi që e tregon ai vetë, nuk kemi të dhana, botoi që në vitin 1585 një vepër me sonete, vjersha e novela, midis të cilave figuronin edhe «Dy kangë të poemës heroike të Skënderbeut» konkretisht kanga e parë dhe e shtatë, të vetmet që mbeten nga kjo poemë, e cila ndoshta nuk u përfundue. Ky shkrimtar, me rastin e një lundërthymje gjatë një udhëtimi nëpër det, doli në brigjet shqiptare dhe, simbas një letre që i shkruen një miku të vet, Bernardin Sanseverinit, Princit të Brinsinjanos, e rrëfen vetë se atje iu kujtue «trimnia e jashtëzakonshme e të pathyeshmit Skënderbe» edhe atje gjeti «tokët pjellore ende avulluese nga gjaku i turqve, triumf i lavdishëm që solli krahu i çel-niktë i të madhit Kastriot». Në këtë valë ndjenjash e kujtimesh Skaramelit i erdhi idea për hartimin e poemës në fjalë. Vepra fillon me përshkrimin e dorëzimit të Gjergjit të vogël bashkë me vëlleznit tek Sulltani. Trimnia dhe triumfet e këtij djaloshi, thekson poeti, e rgritën fronin e Sulltanit në një shkallë të tillë sa që e gjithë bota kishte në gojë vetëm emnin e Skënderbeut.

Pastaj vjen një poemë heroike e pabotueme, që ruhet në qytetin e Padovës, me titull «Rimarrja e Krujës ose i Madhi Skënderbe»; nuk dihet kush asht autori i kësaj vepre.

Poema tjetër e kësaj epoke që, me gjithë të metat që ka, ngrihet mbi veprat e tjera italiane të këtij lloji, asht pikërisht «Skanderbejda» e shkrimtares së naltpërmendun Margerita Sarroki në njizet e tri kangë me strofa tetëshe. Kjo poeteshë u lind në Napoli nga gjysma e shekullit XVI; jetoj e shkroi në Romë, ku edhe vdiq në vitin 1618. Qe grue me talent e me kulturë jo vetëm letrare. Ndoqi me passion zbulimet e Galileut, prandaj u interesue shumë edhe për përparimet e shkencës. Poeteshja në trajtimin e veprës së vet, megjithëse kryesisht mbështetet në historinë e Barlecit, i lëshon shumë fre fantazisë duke krijuar shumë episode, skena e personazhe. Sarroki në pjesën ma të madhe subjektin e poemës e thur simbas frymëzimit dhe imagjinatës së vet; e tregon vetë përmbajtja. Mbasi Gjergji rritet dhe bahet luftëtar i shquem në oborrin e Sulltanit, dërgohet si komandant për një fushatë kundër Beratit, që mbetet i rrethuem. Qytetarët dorëzohen me kusht që të mos preken. Sulltan Murati e urdhënon Skënderbeun që t'i sjellë Dorin, vashën e bukur të Arianitit, mbrojtësit të Beratit, dhe luftëtarët t'i vrasë. Mirëpo Skënderbeu nuk don ta thyejë besën që u ka dhanë të rrethuemve. Atëherë Sulltani me anën e Bajazitit helmatis Skënderbeun, i cili mbasi ka vendosë të kthehet në atdhe shërohet për mrekulli. Pas kësaj nisët që të bahet zot në vend të vet. Forcon Krujën, të cilën Sulltani e rrethon me njiqind e gjashtëdhjetë mijë ushtarë. Mbas disa episodesh, në fund, Skënderbeu në një betejë të madhe del fitues dhe sulltan Murati vdes nga idhnimi.

Poema zë fill me një invokim drejtue Muzës, nga e cila poeteshja kërkon frymëzim për të këndue dhe përjetësue të madhin hero. Që në fillim jepen tiparet dhe cilësitë e Skënderbeut: i urtë e fis-

nik, guximtar e trim, ai ka rrejtun të pastër e të paprekun gjakun e fisit të vet ndonse në vend të huej e aq ma tepër në oborrin e një sulltani. Gjergji parafytyrohet në imagjinatën e poeteshës me veti të morale të denja për një bir shqiptari, megjithëse rrethanat e jetës e kanë detyrue të jetojë e të veprojë në një rreth krejt të ndryshëm e të kundërt me atë në të cilin ishte lindë e rritë.

Krahas këtyne vetive shpirtnore poetesha thekson edhe fuqinë fizike të Skënderbeut. Na paraqitet Gjergji si një luan që, derisa asht i vogël, qëndron nën drejtimin e shufrës së të ozt; por sa vjen e rritet, ajo rreptësi dhe egërsi, që mbaheshin të ndryme, shpërthejnë; tani që krifja asht bamë e potershme dhe kthetrat janë mprehë jashtëzakonisht, ai kall tmerr e ban kërdi.

Në kangën e dytë në del heroi në çastet kur i helmatisun lufton me vdekjen. Si lisi degëmadh, që, rrëzue përdhe, duket edhe ma kolos, apo si egërsinë që e plagosun randë e fshikëllon tokën me rrahjet e bishtit të tmerrshëm, ashtu edhe Skënderbeu, në përleshje me vdekjen, bahet copë, nxjerr djersë të ftohta, por në fund shpëton nga helmatisja.

Mbas kthimit në vendlindje e shohim Gjergj Kastriotin të shoqnuem nga Arianiti. Figura madhështore, qëndrimi burrnor e hijerandë, biseda plot urti e kreshnikut, i frymëzojnë Arianitit shpresë, besim, siguri në fitore. Po edhe në fushën e betejës në qoftë se shpërthen nga njena anë anmiku si oqean i furishëm, nga ana tjetër turret edhe Skënderbeu si Orioni i mbështjellun me re të zeza kërcënuese. Kushtrimi i tij në ato çaste i ndez luftëtarët dhe prapë këtu ndërhyjnë krahasimi: si ai luani i ri që në përleshje me një ari të potershëm, tue luftue me kthetra e me dhambë, merr edhe ma zemër porsa sheh se i vjen në ndihmë luanesha nanë, ashtu edhe trimat shqiptarë, në kacafytje me turkun, bahen si luanë të vërtetë porsa shohin kapidanin e vet, shpata e të cilit korr koka, copton mburoja, parzmore e përkrenare. Me sa mund të tundet mali nga hobeja e një fëmije, aq tundet Skënderbeu prej goditjeve të anmikut; ai si një pyrg i lartë edhe së largu e përku dhe e shtyp turkun. Po njëkohësisht në personin e këtij heroi gjejmë edhe fetarin e devoçëm që, përpara se të hyjë në betejë, shkon të rrëfëhet bashkë me rrethin e vet, diçka jo e zakonshme për heroin e një vepre epike. Këtu duket sheshit ndikimi i fortë i frymës fetare të kohës në personin e vetë shkrimtares. Veç kësaj në poemë gjejmë edhe hiperbolizime që e ngarkojnë randë figurën e Skënderbeut, e zbejnë dhe ia mbulojnë ato cilësi që do ta nxirrnin ma njerëzor, ma tërheqës e ma real. Duket e teprueme skena në të cilën Skënderbeu na çfaqet me karakteristikat e një gjysmë-hyjnie: e shohim të ulun në fron me skeptër në dorë, ka fytyrën e zanin e një mbinjeriu, s'ka burrë që të mund t'i qëndrojë vështrimit të tij.

Aq ma tepër kur vjen rasti për ta paraqitë heroin në fushën e betejës, poetesha, nën ndikimin e poetëve të mëdhenj, sidomos të kohës, përdor pa kursim metafora, krahasime e mjete të tjera artistike për të theksue sa ma shumë madhësinë dhe heroizmin e Skënderbeut.

«Si shpendi grabitqar mbi zogjtë e tjerë
mbi shqerka e dele, si luan i Azisë,

Skënderi mbi ta bën kërdi e tmer
Si ndëshkonjës i rrebtë i drejtësisë».

Edhe kur asht rasti për antiteza shkrimtarja gjen tipin diame-tralisht të kundërt me natyrën e heroit tonë. Tarsi, luftëtari ma i fuqishëm i Sulltanit, paraqitet si fenomen i llahtarshëm që përplas-et verbërisht dhe shkatërron, kurse Skënderbeu del shumë i për-mbajtur, «i harmonishëm në lëvizje, i rrufeshëm në goditje, ka ru-rin e bukurinë e Marsit apo të Minervës».

«Duket tartari Tars me të vërtetë
një djall që shpirtrat grin kur në ferr zbresin
dhe i paepur mbret i Shqipërisë
përngjet me perënditë e lashtësisë».

«Të gjithë janë të bindur se Skënderbeu është një kreatyrë e mbi-natyrshe dërguar nga Perëndia për të ndëshkuar me shtatën flak-ruese mëkatarët».

Kur Skënderbeu përleshet me një nga elefantët që kanë sjellë persianët, ndonse vetëm për vetëm me të, nuk tronditet, e qëllon randë me shtizë dhe e përplas përdhe.

Sulltani mahnitet kur sheh se vigan i Skënderbe «ka ngritë një mal kufomash dhe ngjan në atë det gjaku të paanë shkëmb hekuri që s'e tund era e tërbuar».

«Por Skënderbeu, e Arbërisë lavdia
tmersisht përball turqit e mallkuar,
porsi luani lufton gadi pa shokë,
njëmbëdhjetë kapedanë ka shtrirë për tokë».

«Heroi i mrekullueshëm poshtë e lart
nga njëra shkon rrufe në tjetrën anë,
në rreshtat futet, del, fshihet e duket
porsi një yll mes resh që ndrin e zhduket».

Të tilla përshkrime janë karakteristike të kohës; kanë tonin, shijen, stilin e stërhollë të Gjashtëqindshit në Itali, epokë e deka-dencës letrare-artistike plot shprehje metaforike, plot krahasime e si-milituda të teprueme, plot hiperbolizime e retorizma, që ziejnë edhe në veprën e Skarrokut. Prap disi i tepruem del përshkrimi simbas të cilit Skënderbeu «kaluer në shpinë të gjogut vigan i prin një turme trimash me të cilët u vjen në ndihmë të vetëve; ai, i mbërthyer krejt në hekur, vezullon mu si ylli Mars që andej nga e pesta sferë e qiellit lëshon rreze të forta ndër sy tanë». Një Skënderbeu i tillë i mbuluem në armaturë hekuri plot shkëlqim ka diçka të herojve kalorsiakë që nuk janë të botës shqiptare, del një figurë që nuk i shkon sferës arbnore, d.m.th. ndonjëherë kemi një «evropianizim» të figurës së Skënderbeut.

Një vepër tjetër e kësaj epoke mbi Skënderbeun asht tragjedia në vargje «Shqipnia e sulmueme», dorëshkrim me një prolog dhe pesë akte nga autori «Arkanxhelo», frat i urdhënit të Observancës. Kodi në të cilin asht shkruar kjo tragjedi ndodhet i lidhur në pergamenë dhe ka të shënuem vitin 1651. Kjo vepër i përket gjinisë së

tragjedisë së quejtun «appassionata» të tipit të tragjedive të Gjashtëqindëshit në Itali, në qendër të të cilave spikat pasioni i dashurisë. Vepra asht thuejse krejt një krijim i fantazisë së poetit. Elementi historik çfaqet vetëm në personin e Skënderbeut dhe në fjalët e tija. Ndikimi i kryeveprës së Torquato Tasso në këtë tragjedi ndihet jashtëzakonisht. Veprimi dramatik zhvillohet lirisht dhe shpejt, prandaj për çudi gjejmë një shmangje nga stili dekadent i kohës, s'ka fraza tepër enfatike as shprehje metaforike jashtë mase. Megjithate nuk mungon toni deklamues. Figura e Skënderbeut, që çfaqet rrallë, del me të vërtetë e lartë: udhëheqës shembullor, burrë fjalëpakë e trim i pashoq; ai ma tepër shquhet si njeri veprimi. Fjala e tij asht fjalë burrash, fjalë e preme. Pjesët që i kushtohen Skënderbeut, janë nga ma realët, në pajtim të plotë me shijën e kohës sonë. Kur Lesbini, përfaqësues i Ismenit, d.m.th. i Sulltanit, merr guximin ta quejë Skënderbeun princ rebel, ky i përgjigjet: «T'i thuash atij zotit tand Ismenit se gjithmonë kam qenë besnik dhe jo rebel... Ai pa asnjë arësye më detyron të luftoj. Por, mbasi luftë ai dashka, luftë do të ketë». Madhështia dhe heroizmi i kreshnikut krutan ndihen thellë edhe gjatë gjithë zhvillimit të dramës në dialoge e përshkrime, ku Skënderbeu çfaqet si luan i tmerrshëm, që bën kërdi mbi anmikun. Edhe si figurë dramatike hero i ynë në këtë vepër del një vigan kundrejt personazheve të tjera.

Gjatë shekullit XVIII na tërheqin vëmendjen dy vepra të tjera italiane mbi Skënderbeun: drama në prozë me tre akte e Anton Xanibonit titullue «Trimnitë e princit Skënderbe, mundësit të sulltan Muratit», botue në Bolonja në v. 1730 dhe një vepër tjetër për të cilën do të flasim ma poshtë.

Drama e Xanibonit ka njëthurje dramatike mjaft të bukur dhe me efekt skenik; aty gjejmë shumë krijime të imagjinatës së autorit. Gjatë rrethimit të Krujës Arianiti dhe e bija Donika, e fejuemja e Skënderbeut, bien rob në duert e Sulltanit, por nga ana tjetër edhe e bija e Sulltanit Asteria, e rrëmbyeme prej një kapidani shqiptar, ndodhet në duert e Skënderbeut, i cili, duke dashë që të veprohet me urtësi e drejtësi nga të dy anët, dërgon përfaqësues te sulltani me propozim që të bahet shkëmbimi i robëve. Sulltani, me bindje se do ta thejë Skënderbeun dhe do ta marrë Krujën sa ma parë, refuzon. Zhvillohen luftime të rrepta. Ushtria turke shpartallohet në sajë të trimnisë së Skënderbeut. Sulltani vret veten dhe Arianiti e Donika shpëtojnë.

Dy figurat ma të spikatuna të kësaj drame, Skënderbeu dhe Sulltani, formojnë kontrastin ma të fortë me tipare krejt të kundërta midis tyre. Cilësitë e larta morale të Skënderbeut theksohen mirë përkundrejt natyrës së dobët dhe sjelljes së ulët të Sulltanit, që në zjarrin e një pasioni të shfrenuem, refuzon t'i kthehet e bija me qëllim që të mbajë për vete të bukurën Donikë. Qëndrimi burrnor e fisnik po edhe i drejtë i Skënderbeut shprehet edhe në fjalët që ai i drejton Asteries: «Po të kisha edhe unë natyrën shnjerezore të prindit tand mizor, pa pritë asnjë çast, do ta pësoje edhe ti atë që pësun tre vëlleznit e mi të helmatisun. Mirëpo, mbasi ai që mbretnon në Shqipëni e ka për lavdi të jetë anmik i sulltanit e jo imitues i tij, këtu në oborrin tem ti do të trajtohesh ma tepër si mbretneshë se sa si robneshë. Por, në qoftë se ai guximtari Murat, që na qenka tepër

ashik, harron se asht prind dhe i bie moh vajzës së vet për të mbaj-të nusen teme, atëherë le ta harrojë edhe Skënderbeu atë sjellje bu-jare e cila deri tashti e ka mbajtur larg nga hakmarrja e menjihershme...». Në aktin e dytë, ku del se Sulltani ka vendosë të mos e pranojë propozimin për shkëmbimin e robëve, Skënderbeu aspak nuk tronditet; atë s'e tremb as moria e luftëtarëve të Sulltanit, as mizoria e tij. Në ato çaste dramatike vetëm fjalë të urta dëgjojmë nga goja e kreshnikut tonë: «Burri i vërtetë nuk trembet prej asaj force që mbështetet në mizori. Sa ma brutal që të sillet ai kundrejt prince-shës, nuses sime, aq ma tepër atë do ta urrejnë luftëtarët e tij; nuk asht i denjë për fitore ai që marshon drejt saj me hapa tiranie».

Vepra tjetër italiane, po e shekullit XVIII, asht një punim poetik rreth shtatëdhjetë faqesh i autorit Mauricio Gerardini Veroneze me titull «Skënderbeu, princ i Shqipënisë», një farë drame, veprimi i së cilës zhvillohet në Krujë. Kjo pjesë do të çfaqej në praninë e Fran-çeskut III, dukës së Modenës, me rastin e datëlindjes së tij në v. 1770. Veprën nuk e kemi, pra s'dimë ma tepër as për atë as për autorin e saj.

Në shek. XIX gjejmë dy vepra italiane mbi Skënderbeun, të cilat kushtëzohen nga vetë rryma e re politike, shoqënore e letrare e kohës. Sikurse dihet, Revolucioni borgjez Francez pati jehonë të madhe edhe në Itali; ai vuni në lëvizje masat popullore për t'u çlirue nga zgjedha feudale dhe e huej, për bashkimin shtetnor të të gjithë vendit; kjo lë-vizje mori emnin «Risorgimento». Rritja politike e masave popullore të Italisë u pasqyrue mirë në letërsinë italiane të kohës, sidomos në veprat e Romantizmit përparimtar. Në këtë valë liridashëse dolën edhe në Italinë Jugore shkrimtarë të tillë, ndër të cilët edhe arbë-reshi Jeronim de Dada, që ndikoi shumë në shkrimtarë të tjerë jo vetëm arbëreshë, por edhe italianë. Në vazhdim të kësaj rryme të re del në vitin 1874 romani «Skënderbeu» nga Antonio Xonkada dhe më 1886 poema profane «Skënderbeu» nga Xhuzepe Mantika.

Antonio Xonkada ka qenë patriot dhe letrar i shqem. Që në moshë të re mori rrugën e priftnisë, por njëzetvjeçar e flaku petkun e zi dhe mori pjesë në lëvizjet revolucionare të dzyzetetëtës. Qe profesori i letërsisë italiane në Universitetin e Pavisë. Ka botue studime, novela, romane historike, poezi e përkthime.

Vetë nëntitulli i veprës së Xonkadës «Histori shqiptare e sheku-llit XV» tregon se ky shkrimtar, sikurse del konkretisht, e end romanin e vet në bazën e «Historisë së Skënderbeut» të Barleciit tue e pajisë me përshkrimet e veta imagjinate, që shpesh zgjaten edhe tepër. Qysh në faqen e dytë shkrimtari e quen fatbardhë qytetin e Krujës «që pa të lindte brenda mureve të veta ndoshta ma të ma-dhin kapidan të kohës, tmerrin e turqve, njeriun e legjendave, he-roin e kangëve popullore». Romani ze fill me përshkrimin e festës madhështore me rastin e martesës së Skënderbeut. Në mes të një kortezhi të shkëlqyeshëm plot princa e kapidanë, në mes të një pu-bliku të pamasë «figura e Skënderbeut kishte atë pamje me të cilën njerëzimi kënaqet ndonjë herë t'i japë formë të gjallë idealit të he-roit, d.m.th. atë pamje me të cilën paraqiten Aleksandri i Madh, Cezari e Napoloni». Si Eneu, që në kangën e dytë të Eneidës, mik në palla-tin e Didonës, me lutjen e kësaj mbretneshe, fillon të përshkruejë shtatërrimin e Trojës, ashtu edhe Skënderbeu në gostinë e dësmës

së vet, nis të endë historinë e veprimeve të guximshme, të heroizmeve të veta deri në kthimin triumfes në atdhe. Përshkrimi merr hov me një ton përherë e ma dramatik në çastet kur Skënderbeu përqëndrohet në kujtimin e arritjes te porta e Krujës bashkë me treqind burrat e tjerë. Për të krye ndërmarjen e guximshme, heroit tonë, siç tregohet në roman, i kishin ardhë në ndihmë vetë bashkëqytetarët nga brenda, në mes të një stuhie të potërshme që atë natë e kish lëshue vetë natyra. Pastaj kish kërdia mbi pushtuesit turq.

Nga fundi i romanit, gjithnjë në sferën e stilit romantik, na çfaqet një skenë madhështore me një kontrast të theksuem. Në një fushë thuejse të pafund nuk të sheh syni tjetër veçse shatorre; asht ushtria turke, ushtri e pamasë, që ka depërtue thellë në tokën arbore. Tue mos e përfillë fare vigjilencën, strategjinë dhe forcën e Skënderbeut, komandantët dhe ushtarët aniq qëndrojnë të shkujdesun në vapën e atyne ditëve, tue qenë të sigurtë për fitore. Atje lart majë një shkambi ka zanë vend Skenderbeu bashkë me Mandragasin, një nga kapidanët e vet. Të dy i ngulin sytë atje poshtë. «Në atë lamje të dyvet u ngufon zemra prej një gëzimi të paprovuem rdonjëherë. Skënderbeu në një çast i rrok dorën shokut dhe thyen heshtjen me këto fjalë: «Ja se në ç'gjendje janë katandisë pushtuesit e Lindjes. Për Zotin, mos më thaçin Dragoi i maleve, në mos i shpartallofsha brenda pak kohe mu si dhentë!». Dhe ashtu ngjau.

Përveç personazheve historikë në veprën e Xokadës gjejmë edhe një galeri personazhesh të sendergjuem, historia e të cilave shpesh shtrihet prej një kapitulli në tjetrin, andaj dalin digresione të vazhdueshme. Megjithëse autori përpiqet t'u japë ngjyrë lokale disa episodeve, prapëseprapë i kalon kufijtë e sferës shqiptare: kështu që aty thuren edhe elemente tipike të jetës evropiane. Karakteristike janë vajtimet në vjersha të zonjave shqiptare me rastin e humbjes së burrave të tyne në luftimin e përgjakshëm të Beratit. Tradhëtia e Moisiut, pendimi, kthimi dhe heroizmat e tija të fundit, fushata e guximshme e Hamzë Kastriotit kundër ungjit të vet, disfata dhe kapja e tij përfshijnë një pjesë të madhe të këtij romani. Rrallë del në skenë Skënderbeu, por, kur çfaqet ai, veprimi i tij i shpejtë e vendimtar merr emnin fitore. Edhe atëherë kur në shtjellimin e disa episodeve ose të ndonjë historie të zgjatun mungon pjesëmarrja efektive e heroit tonë, prapë mbizotnon si të thuesh, hija e tij, figura e tij del si nyjë themelore e veprës.

Romani mbyllet me kthimin triumfues të Skënderbeut në Krujë fill mbas fitores mbi të nipin. Ky triumf ka po atë madhësi e shkëlqim që kish pasë festa me rastin e martesës së tij. Megjithëse romani e përshkon fund e krye fryma romantike me një farë lirizmi dhe me një fryrje episodesh e të dhanash historike, prapë mund të thomi se profili i heroit tonë del i gjallë, real e i natyrshëm, d.m.th. i zhveshun prej asaj aureole, prej atyne hiperbolizimeve të poemave të shekullit XVI-XVII.

Randësia e roli i Skënderbeut në mbrojtjen e lirisë dhe të qytetnimit evropian dalin qartë në këtë shprehje plot mirënjohje të romancierit Xonkada: «Italia jonë, e cila rrezikun e barbarizmit aziatik e pati shumë afër, Italia, e cila mban në gji të vet stërnipat e të arratisunve të dikurshëm shqiptarë, që me vdekjen e Skënderbeut e kër-

kuen këtë tokë për strehim, mue më duket se duhej ta harronte Skenderbeun ma pak se çdo komb tjetër».

Kësaj periudhe i përket edhe vepra në pesë kangë e shkrimtarit Mantika me titull «Skënderbeu», që mund të quhet një poemë «sui generis» për faktin se përmes shtjellimit të subjektit autori ka thurë edhe çashtje aktuale, shoqërore e personale me një ton gazmor, me humor dhe, aty-këtu, me një frymë satirike të tillë në adresë autoritetesh, klerikësh e zakonësh, saqë një trajtim i tillë nuk pajtohet edhe aq me seriozitetin e temës, ndonse digresionet lidhen me argumentin themelor ose me episodet në mënyrë mjaft të natyrshme. Shkrimtari kërkon ta përligjë këtë lloj trajtimi mu në strofën e parë, ku rrefën se poemave të tipit klasik u ka kalue koha dhe kërkon falje në rasë se gjatë shtjellimit të veprës do të ndërhyjnë digresione, fjalë të pavend e të guximshme, ndonjë varg jo aq i goditun, pra merr liri ta trajtojë poemën ashtu si t'i teket, por premtan se do ta kënaqë lexuesin. Megjithatë ky shkrimtar, ndonse hartimin e një poeme simbas modeleve klasike ban sikur e quen anakronike për shekullin XIX, sa herë që ngrihet në sferën e një trajtimi serioz të subjektit, qëndron në lartësinë e duhun.

Filli përçues i kësaj poeme asht historia, por aty, natyrisht, mbi-zotnon imagjinata, fryma romantike. Që nga fillimi i kangës së parë bie në sy një mendim origjinal i autorit, i cili thotë se nuk do të këndojë «heronë e fesë, ashtu siç e kanë paraqitë Skënderbeun shumë të tjerë, sepse nga historia duket qartë se atij i asht dashhtë t'i mbronte të krishtenët për t'i vu një themel të shëndoshë pushtetit të vet dhe për të pasë ndihmën nga perëndimi».

Në këtë poemë spikat në mënyrë të veçantë Gjergj Kastrioti djallë i ri në oborrin atnor; shquhet për pashi e urtësi, për rreptësi e vepër të guximshme në tokë e në det.

Në sulmin e papritun të hordhive turke kundër pallatit të Kastriotëve që, simbas papritazisë së poetit, ngrihej majë një shkambi buzë detit, turret djaloshi Gjergj si luan me jatagan në dorë dhe ban kërdi; por tërbimi i tij arrin kulmin kur sheh të bukurën e vet në krahët e një turku asgan, të cilit në çast i këput kokën. Pra një nga karakteristikat e rinisë së Skënderbeut, ashtu siç përshkruhet në këtë poemë, asht edhe dashunia për të bukurën e vet, një dashuni e singertë që gjen shprehje në skena idilike në mes të natyrës arbnore. Vajza me një lirizëm, që i ngufon nga zemra, e parafytyron Gjergjin herë në kthim nga gjuetia, ngarkue me egërsinë e herë në kthim nga luftimi, lye me gjakun e anmikut. Një pjesë e poemës kalon me përshkrimin e trimnive të Skënderbeut edhe në oborrin e Muratit. Edhe këtu gjejmë episode dashunë. Jerina, një nga të bukurat e sulltanit, e mahnitun prej hijeshisë dhe heroizmave të Gjergjit, digjet në dashuni për të e për pasojë vijnë edhe takimet midis tyre.

Nga fundi i veprës një vend të konsiderueshëm e ze përshkrimi i jetës bashkshortore të Skënderbeut me Donikën në një atmosferë qetësie e lumtunie, ku shpesh edhe vetë heroi rëmbehet në kundrimin e së kaluemes e sidomos të rinisë së vet heroike. Mallëgjimi dhe fantazia e tij marrin edhe ma hov kur vetë Donika merr qestën në dorë dhe nxjerr melodi të bukura e të ambla. Pastaj Derën e Kastriotëve vjen ta ndriçojë e ta gëzojë lindja e trashigimtarit Gjon dhe me këtë merr fund poema. Në të vërtetë një mbyllje e tillë e ul mjaft tonin

epik të veprës. Një përfundim i tillë nuk pajtohet me atë që do të pris-
to lexuesi prej një Skënderbeu udhëheqës e trim mbi trima; lexuesi
do të dëshironte që poema të mbyllet me një kthim triumfues të he-
roit tonë ose me një fitore dërmuese mbi armikun. Megjithatë, po të
krahajojmë për shembull Skënderbeun e Mantikës me atë të Xonkadës,
edhe pse njeni e trajton në një poemë epike dhe tjetri në një vepër
të artit narrativ, na shohim se në të dy anët, në figurën e heroit dalin
pak a shumë të njajat tipare, që si metodë artistike e si stil, ndry-
shojnë nga ato të shekujve të maparshëm. Pra edhe te poema e Man-
tikës gjejmë një Skënderbe ma njerëzor, ma real, ma të afërm me ne.

Mbi Skënderbeun kemi edhe dy vepra të tjera italiane të kohës
sonë, romanin «Skënderbeu, Shqiptonjë e Shqipërisë» të vitit 1940 nga
Xhovana Biazoti dhe broshurën «Gjergj Kastrioti i quejtun Skenderbe
— Një faqe e madhe e Epopesë shqiptare» një farë proze poetike, nga
Xhuzepe Antoneli të vitit 1940, vepra propagandistike që dalin në ko-
hën e okupacionit fashist të vendit tonë, dy vepra, në kuptimin e vër-
tetë të fjalës, me porosi. Në faqet e fundit të këtyne dy veprave del se
Shqipnia, mbas ma mundimesh e luftash politike të vjetra e të reja, pas-
ka gjetë gjoja mbrojtje e siguri vetëm në prehnin e Italisë fashiste. Aty
duket qartë se nën maskën e naltësimit të figurës së Skënderbeut dhe
të popullit shqiptar, fshihen qëllimet imperialiste të një regjimi shty-
pës e shfrytëzues siç ishte regjimi fashist.

Po t'u hedhim një vështrim të përgjithshëm veprave, të cilat u
përshkruan, do të shohim se gjatë shekujve figura e Skënderbeut, du-
ke qëndruar në lartësinë e denjë që i jepet, merr aspekte dhe përpjes-
time të ndryshme simbas shijes dhe rrymave letrare që mbizotnojnë
në epoka të ndryshme në Itali dhe simbas qëllimeve të autorëve. Në
veprat e shekujve të maparshëm profili i Skënderbeut vizatohet me
përpjestime ndonjëherë mbinjerëzore sidomos në sajë të figurave, të
metaforave, të krahasimeve të shumta, të një stili të lulëzuar e reto-
rik, kështu që në mendjen tonë parafytyrohet një hero, të thuesh, le-
gjendar me tiparet kalorsiake të mesjetës, siç pamë te poema e
Sarrokut.

Përkundrazi në veprat e shekullit XVIII dhe XIX përfytyrimi arti-
stik i figurës së Skënderbeut del ma i natyreshëm, ma real, bile në
ndonjë vepër na shohim se hero i ynë përshkohet edhe nëpër episode da-
shunie dhe kjo ndoshta aty për aty na duket diçka e jashtëzakonshme,
mbasi në personin e Kreshnikut tonë jemi mësue të shikojmë anën
burrnore, heroike. Mirëpo, derisa në gjinitë e ndryshme letrare, si në
poema, tragjedi, drama etj., shpesh nija kryesore asht elementi ero-
tik apo ndjenja e dashunisë, nuk duhet të çuditemi në qoftë se në
ndonjë vepër, si te poema e Mantikës, gjejmë një Skënderbe, dhe aq
ma tepër një Skënderbe të ri, të rrëmbyem prej një pasioni të tillë,
që gjen zbatim në skena idilike.

Pavarësisht nga trajtimi i subjektit simbas shijes dhe rrymave të
ndryshme gjatë shekujve, fakti asht se në veprat e shkrimtarëve ita-
lianë të naltpërmendun, me përjashtim të dy veprave të kohës së re-
gjimit fashist, del në mënyrë të sigurtë një qëllim i përbashkët: të
ngrihet sa ma nalt me fuqinë e artit Udhëheqësi e trimi shembullor,
Mbrojtësi i atdheut dhe i Evropës nga rrebeshi aziatik.

R é s u m é

SKANDERBEG DANS LA LITTÉRATURE ITALIENNE

La geste glorieuse de notre héros national, Georges Kastriote-Skanderbeg, a donné l'inspiration à plusieurs hommes de lettres étrangers pour des productions historiques et littéraires. En Italie, à partir du XVI^e siècle, plusieurs hommes de lettres ont chanté aux gestes et aux grands mérites de Skanderbeg. Le chef-d'oeuvre de notre patriote et humaniste, Marinus Barletius, a exercé une remarquable influence aussi parmi les premiers écrivains italiens qui ont composé des poèmes sur notre héros, comme Baldassarre Scaramelli et notamment Margherita Sarrocchi, l'auteur de la Scanderbeide. Il s'agit d'un poème épique en 23 chants, où la figure de Skanderbeg est peinte dans toute sa grandeur, quoique l'oeuvre portât les traits du style décadent du XVII^e siècle en Italie. Skanderbeg y est brossé avec les traits du preux chevaleresque.

Au XVII^e siècle on a le drame en vers d'Arcangelo, intitulé L'Albania combattuta, une création de fantaisie du poète. L'élément historique y est manifesté dans la seule personne de Skanderbeg, qui dans cette production est peinte comme un éminent stratège et un «preux parmi les preux».

Durant le XVIII^e siècle, l'attention est attirée par une pièce d'Antonio Zaniboni, où est mis en vue notamment le contraste entre les hautes qualités morales de Skanderbeg et le caractère sournois, le comportement bas du sultan Murad.

Au XIX^e siècle on trouve en Italie deux autres productions sur Skanderbeg: un roman d'Antonio Zoncada, et un poème profane de Giuseppe Mantica. Zoncada fait flâner son roman sur les traces de l'histoire de Barletius, mais avec un grand nombre de digressions. La figure de Skanderbeg ne vient que rarement sur la scène, mais quand elle se présente, son action rapide et décisive prend le nom de «victoire». Il convient de faire noter la reconnaissance qu'exprime cet écrivain envers notre héros, comme défenseur de la civilisation européenne contre la tourmente asiatique.

Dans le poème en cinq chants de Giuseppe Mantica, Georges Kastriote est fait remarquer, notamment comme un jeune homme, dans la cour paternelle, pour sa beauté et sa sagesse, pour sa vaillance et son hardiesse. A la fin est décrite la vie conjugale de Skanderbeg avec Donique dans une atmosphère de tranquillité. Cette fermeture fait perdre sensiblement au ton épique du poème.

En 1940 ont paru deux productions italiennes sur Skanderbeg. Il est évident que leur édition a été faite dans des buts politiques. Sous le masque de l'élévation de la figure de Skanderbeg et du peuple albanais, on fait effort pour justifier la conquête fasciste et à camoufler les visées impérialistes de l'Italie fasciste envers notre pays.

Si l'on jette un regard d'ensemble aux productions en question, nous verrons que durant les siècles, la figure de Skanderbeg se tient à cette hauteur qui est digne de lui. Elle est ébauchée sous des aspects et des proportions différentes, d'après les goûts et les courants littéraires qui prédominent en différentes époques en Italie, ou bien d'après les buts des auteurs.

Dans les productions des siècles antérieurs, le profil de Skanderbeg est dessiné parfois dans des proportions surhumaines, notamment au moyen des figures, des métaphores, des comparaisons nombreuses, d'un style fleuri et rhétorique. C'est ainsi que dans notre esprit est représenté un héros qui rejoint presque la légende, avec les traits chevaleresques du moyen âge, comme p. ex. chez la femme de lettres Sarrocchi.

Au contraire, dans les productions des siècles XVIII et XIX, la représentation artistique de la figure de Skanderbeg se tient plus aisément au naturel, à la véridicité. Dans quelque ouvrage on voit que notre héros est représenté emporté par la passion de l'amour. Cela donne à l'oeil notamment, si l'on tient compte du fait que notre héros est représenté dans son seul aspect viril. Cependant, compte tenu que dans les différents genres littéraires, comme le poème, la tragédie, le drame, etc., le canevas fondamental est souvent l'élément érotique, on ne doit pas être surpris si dans quelqu'une de ces productions, comme p. ex. dans le poème de Giuseppe Mantica, l'on trouvât Skanderbeg emporté par la passion.

Le reflet de l'époque et de la figure de Skanderbeg dans plusieurs productions de la littérature italienne, confirme le fait que la gloire de notre héros, qui pendant plus d'un quart de siècle est devenu l'écu de la liberté du pays et de la civilisation européenne en général, a débordé les frontières de son pays et s'est imposée au monde.

